

Pasuritë natyrore dhe trashëgimia e Basenit të lumit Drin: Në frymëzim të aksioneve tona të përbashkëta



© MIO-ECSDE 2018

12, Kyrristou str., 10556 Athens, Greece

tel: +30 2103247490, +30 2103247267, fax: +30 2103317127, e-mail: info@mio-ecsde.org, website: www.mio-ecsde.org

Written by: Thomais Vlachogianni (MIO-ECSDE)

Editor-in-Chief: Michael Scoullas (MIO-ECSDE)

Text editing: Anastasia Roniotes (MIO-ECSDE)

Front cover photo: *Pelecanus crispus* © Milan Vogrin

Back cover photo: *Orthetrum cancellatum* © Thomais Vlachogianni

Layout: Antonis Kapiris, Tamgram Creative Studio

Pasuritë natyrore dhe trashëgimia e Basenit të lumit Drin: Në frymëzim të aksioneve tona të përbashkëta

Albana Bregaj, Erjola Keci, Rizah Hajdari

Falënderime të veçanta për Ivana Lozanovska, Mehmet Metaj, Milan Vogrin dhe Irene Koutseri për këshillat e tyre të vlefshme.



Publikimi është riprodhuar në kuadër të Drin CORDA (Veprimtari të Koordinuar për Drinin) me mbështetjen e projektit të GEF për Drinin. Publikimi u zhvillua nga MIO-ECSDE (Zyra e Informacionit Mesdhetar për Mjedis, Kulturë dhe Zhvillim të Qëndrueshëm - një Federatë e OJQ-ve mjedisore të Mesdheut) në kuadër të projektit "Veprimtari për Drinin (Act4Drin)" të financuar nga Fondi i Partneritetit të Ekosistemeve Kritike. Publikimi pasqyron pikëpamjet e autorëve dhe nuk përfshin donatorët.

Ky publikim është në dispozicion në internet në: www.mio-ecsde.org dhe www.act4drin.net.

Dokumenti i përmbahet rregullave dhe politikave të OKB-së lidhur me emrat dhe statusin ndërkombëtar të vendeve dhe/ose zonave të tjera gjeografike, etj. Përdorimi i karakterizimeve, emrave, hartave apo deklaratave të tjera gjeografike në këtë dokument, në asnjë mënyrë nuk nënkupton ndonjë pikëpamje apo pozicionim politik të palëve të përfshira në zhvillimin dhe riprodhimin e këtij publikimi. Përdorimi i termave ose deklaratave në këtë publikim në asnjë mënyrë nuk pasqyron ndonjë pozicion të MIO-ECSDE në këtë fushë.

ISBN: 978-960-6793-19-6



ACT 4 DRIN

Living well in harmony
with the Drin

Vlera esenciale e basenit të lumit Drin është e çmuar - kjo është përtej dyshimit i të qenit një nga pikat e nxehta më të rëndësishme të biodiversitetit të ujërave të ëmbla në Evropë. Nëse arrijmë ta kuptojmë apo jo, ekosistemet e ujërave të ëmbla, së bashku me çdo grimë të biodiversitetit mbështesin dhe ekosistemin që ato sigurojnë, përcaktojnë cilësinë e jetës dhe mirëqenien. Ne, si individë mund të bëjmë dallimin e vërtetë, duke mbajtur dhe respektuar të drejtën e të gjitha qenieve në këtë planet dhe duke ndërmarrë veprime individuale apo kolektive për mbrojtjen e biodiversitetit të basenit të lumit Drin dhe shërbimeve të paçmuara të Ekosistemit.

Ky publikim ka për qëllim të rrisë ndërgjegjësimin publik mbi vlerën e pasurisë sonë të përbashkët natyrore e trashëgiminë dhe kjo është një shfaqje konkrete e përkushtimit dhe solidaritetit mes OJF-ve mjedisore të rajonit për të mbrojtur dhe ruajtur pellgun ujëmbledhës të lumit Drin. Është ideuar nga Zyra e Informacionit për Mjedisin, Kulturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm në Mesdhe (MIO-ECSDE) në kuadër të projektit Vepro për Drinin (Act4Drin).

Vepro për Drinin (Act4Drin) është një projekt i mbështetur nga Fondi i Partneritetit të Ekosistemeve Kritikë - Critical Ecosystem Partnership Fund (CEPF), drejtuar nga MIO-ECSDE dhe zbatuar në bashkëpunim me KAQKA PRODUCTION, BIOSFERA, Qendra EDEN, GREENHOME dhe MES. Përveç partnerëve të projektit, promotorët e Vepro për Drinin përfshijnë dhe Organizata të tjera të Shoqërisë Civile si: Albaforest, BirdLife në Slloveni (DOPPS), Shoqëria për Hulumtimin e Zogjve dhe Mbrojtjen e Natyrës (DPPVN), Qendra Mjedisore për Administrim dhe Teknologji (ECAT), Shoqata EIRLA, Ambjentalistët e Malit të Zi, Instituti për Mbrojtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA), Instituti i Politikave Mjedisore (IEP), Lëvizja Mjedisore "OZON", Bujqësia Organike dhe e Permakulturës (POA), Shoqata e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA), PSEDA ILIRIA dhe Shoqëria për Mbrojtjen e Prespës (SPP).





ACT 4 DRIN

Living well in harmony
with the Drin

Pasuritë natyrore dhe trashëgimia e Basenit të lumit Drin: Në frymëzim të aksioneve tona të përbashkëta

Përmbajtja

- Baseni i Lumit Drin: Trupi uhor lidhës i Ballkanit jug-perëndimor | 6
- Ndjekja e rrugës së Basenit të Lumit Drin për në Detin Adriatik | 7
- Vlera thelbësore e Basenit të Lumit Drin: pikë e nxehtë përbiodiversitetin | 7
- Baseni i Lumit Drin: Çfarë është me vlerë? | 8
- Baseni i Lumit Drin nën kërcënim: presionet kyç dhe ndikimet | 8
- Liçeni i Ohrit: një nga të paktët liqene të lashtë në Botë | 9
- Liçeni i Shkodrës: liçeni më i madh në Ballkan | 10
- Prespa e Madhe dhe Prespa e Vogël: parajsja për jetën e egër | 11
- Lumi Buna: një mozaik habitatesh të pasur biologjikë | 12
- Drini i Zi dhe Drini i Bardhë | 12
- Llojet në qendër të vëmendjes | 14
- Veprim i koordinuar për një të ardhme të qëndrueshme të Basenit të lumit Drin | 18
- Referencat | 20



Baseni i Lumit Drin: Trupi uhor lidhës i Ballkanit jug-perëndimor

Baseni i lumit Drin shrihet në një pjesë gjeografike rreth 20.000 kilometra katror në Ballkanin perëndimor; baseni shtrihet përmes: Shqipërisë, Greqisë, Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Kosovës dhe Malit të Zi. Baseni i lumit Drin është një sistem ndërlidhës hidrologjik i përbërë nga nën pellgjet ndërkufitare të Liqenit të Prespës së Madhe dhe asaj të Vogël; Liqenit të Ohrit; Liqenit të Shkodrës; Lumit Drin duke përfshirë degët e tij, Drini i Bardhë, Drini i Zi dhe Lumi Buna.



▲ *Leucojum aestivum* © Milan Vogrin

◀ *Phalacrocorax carbo* © Gregor Šubic

Vlera thelbësore e Basenit të Lumit Drin: pikë e nxehtë përbiodiversitetin

Rajoni i Ballkanit është i njohur në Europë si pikë e nxehtë e biodiversitetit, në sajë të historisë së tij si një magazinë akullnajore dhe midis shkëmbimeve floristike dhe faunistike ndërmjet Europës dhe Azisë. Baseni i Lumit Drin është i pasur me jetë, dhe biodiversitet, ai siguron habitate të rëndësishme për shumë lloje të faunës dhe florës. Disa prej këtyre llojeve janë endemike si *Salmo ohridanus*, *Salmo letnica*, *Chondrostoma prespense*, *Scardinius knezevici* etj, ndërsa shumë lloje të tjera rriten në sasi të madhe në basen në krahasim me pjesën tjetër të Europës, si *Pelecanus crispus*, *Pelecanus onocrotalus*, *Pygmy Cormorant*, *Microcarbo pygmaeus*, etj.

Kjo vjen si rezultat i pasojave gjeografike të "fragmentizimit" dhe "izolimit" të pjesëve të sistemeve në: liqene, lugina, shpella karstike nëntokësore, lumenj, zona të gjera malore të pacënuara, ku dendësia e përgjithshme e popullsisë është relativisht e ulët. Megjithatë, kjo po ndryshon.

Ndjekja e rrugës së Basenit të Lumit Drin për në Detin Adriatik

Lumi Drin rrjedh përmes zonës së maleve të Ballkanit Perëndimor në drejtim të Detit Adriatik, duke siguruar kështu shkarkimin e tretë dhe më të madh të lumit në Mesdheun Europian.

Lumi Drin ka dy degëzime kryesore: Drini Zi dhe Drini i Bardhë. Fillea e Drinit të Zi vjen nga Liqeni i Ohrit, rrjedh nëpër Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë nga dhe ku futet në Shqipëri. Drini i Bardhë shtrihet në Kosovë dhe rrjedh në Shqipëri ku takon edhe Drinin e Zi për të formuar Lumin Drin. Njëri degëzim i Lumit Drin në Shqipëri lidhet me Lumin Buna afër qytetit të Shkodrës dhe degëzimi tjetër derdhet direkt në Detin Adriatik në Jug të Shkodrës përkatësisht afër qytetit të Lezhës. Secili nga këta trupa ujorë gjatë rrjedhës, bashkohet me ligatina, degëzime, lumenj të vegjël dhe përrenj.



Fishing trouts at Lake Shkoder/Skadar
© Thomais Vlachogianni



Lake Shkoder/Skadar
© Thomais Vlachogianni



Baseni i Lumit Drin: Cfarë është me vlerë?

Baseni i Drinit është një sistem kompleks i gjallë. Pa përbërësin e tij jetësor ujin, sistemi që shohim dhe njohim sot nuk do të ekzistonte. Uji është një aset kritik për zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e jetës. Nëse ne me vetëdije i kuptojmë apo jo ekosistemet e ujërave të ëmbla, së bashku me çdo grimë të biodiversitetit që ata mbështesin dhe shërbimet e ekosistemeve që ato sigurojnë, janë ngushtë të ndërthurur me ekzistencën tonë harmonike dhe mirëqënien.


Trupat ujorë të ndërlidhur, ekosistemet dhe komunitetet që ata strehojnë, i japin qëndrueshmëri përfitimeve të banorëve të tyre. Të gjitha zonat që shtrihen në gjithë gjatësinë e lumit Drin sigurojnë një burim ekonomik dhe jetik në furnizimin me ujë, bujqësi dhe blegtori, industri, peshkim, rekreacion dhe turizëm, prodhimin e energjisë dhe navigacion. Çdo gjë e çmuar dhe me vlerë duhet të marrë kujdesin që meriton!

Baseni i Lumit Drin nën kërcënim: presionet kyç dhe ndikimet

Përdorimet e ndryshme e shpesh herë konfliktuese dhe përqsjet jo të qëndrueshme të menaxhimit të aplikuara në Basenin e Drinit ushtrojnë presione të ashpra mbi ekosistemet e basenit duke çuar në degradimin e tyre. Disa nga presionet kyç janë: mbetjet e ngurta dhe mbetjet detare, ujërat e ndotur, përdorimi i pa qëndrueshëm i burimeve ujore (përfshirë ndërtimin e digave), nxjerrja e mineraleve/ minierat, bujqësia intensive dhe pylltaria, peshkimi dhe gjuetia e pakontrolluar dhe shpesh e paligjshme, përdorimi jo i rregullt i tokës dhe zhvillimi urban, turizmi i paqëndrueshëm, rritja e ndryshimeve klimatike. Këto presione çojnë në një shkallë të gjerë ndikimesh si: shpyllëzimi, ndotja e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, erozion i përshpejtuar, kripëzim dhe ndërfitje të ujërave të kripur, humbja e ekosistemeve të vlefshme dhe biodiversitetit, përmbytje të ashpra dhe më të shpeshta, rritja e rreziqeve të shëndetit, etj.

▼ *Larus ridibundus* at Lake Ohrid, Albania © Thomais Vlachogianni






Liçeni i Ohrit: një nga të paktët liçene të lashtë në Botë

Liçeni i Ohrit është një nga liçenet më të thellë (maksimumi 280 m), nga më të lashtët në Europë, nga 2 deri në 10 milion vite. Liçeni kryesisht ushqehet nga ujërat nëntokësorë (50%), nga burime të ndryshme karstike (Shën Naumi kontribuon në afërsisht 75% të prurjes së përgjithshme nëntokësore, Tushemishti në 25% të saj) në bregun juglindor të liçenit. Formacioni ujëmbajtës i shtresës karstike e merr ujin nga Liçeni i Prespës, i cili derdhet plotësisht në sistemin karstik 150 m mbi nivelin e liçenit të Ohrit.

Ndoshta për shkak të ekzistencës së gjatë dhe izolimit nga kodrat dhe malet ka evoluar një varietet bimësh dhe kafshësh. Ekzistojnë afërsisht 1200 lloje native nga të cilat më shumë se 220 lloje endemike janë njohur që jetojnë në liçen. Gastropodotë të liçenit (Molluska) janë një shembull i mahnitshëm i endemizmit të lartë.

Liçeni i Ohrit strehon lloje peshqish, midis të Koranin (*Salmo letnica*) dhe Belushka (*Salmo ohridana*). Kallamishtet e bregut liçenor dhe ligatinat sigurojnë habitat për shumë lloje të tjera, prej të cilëve disa janë të rrallë dhe/ose të rrezikuara. Këto përfshijnë, Pelikanin Dalmat, Rosat ngjyrë ndryshku, Shqiponja me pika dhe Shqiponja Perandorake.





▲ *Potamogeton natans* © Milan Vogrin

Liqeni i Shkodrës: liqeni më i madh në Ballkan

Ndër Liqenet e Ballkanit është dhe Liqeni i Shkodrës, i cili ka sipërfaqen më të madhe në gadishullin Ballkanik. Liqeni ndahet midis Shqipërisë dhe Malit të Zi në kufi të pjesës perëndimore të liqenit. Lumi i Bunës lidh Liqenin e Shkodrës me Detin Adriatik, ndërsa Lumi Drin siguron lidhjen me Liqenin e Ohrit.

Liqeni i Shkodrës është një zonë e njohur biodiversiteti ujërash të freskët dhe strehon një gamë të gjerë llojesh enemike e të rralla, apo lloje të rrezikuar bimësh dhe kafshësh. Veçanërisht në sajë të faunës së pasur të



◀ *Nuphar luteum* © Milan Vogrin



▲ *Pelophylax kurtmuelleri* © Thomais Vlachogianni

Prespa e Madhe dhe Prespa e Vogël: parajsa për jetën e egër

Pellgu ujëmbledhës ndërkufitar i Prespës përbëhet nga dy liqene: Prespa e Madhe dhe Prespa e Vogël të ndara nga një rrip toke i ngushtë. Kufijtë e Shqipërisë, Greqisë dhe Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë takohen në ujërat e të dy liqeneve të Prespës. Prespa e Madhe është një nga liqenet më të vjetër në Evropë, që ushqen nëpërmjet burimeve nëntokësore në veriperëndim, liqenin njësoj të vjetër (por shumë më të madh) të Ohrit. Prespa e Vogël ndahet ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë.

Të dy liqenet e Prespës kanë qenë të bashkuar në një basen të vetëm, por në vitet '70 ata u ndanë në mënyrë që të menaxhohej niveli i ujit në Prespën e Vogël. Mendohet se ujëmbledhësi i Prespës së bashku me Liqenin e Ohrit dhe Liqenin e tharë të Maliqit (Baseni i Korçës) janë pjesa e mbetur e një sistemi liqenor të zgjeruar miliona vjeçar. Pellgu ujëmbledhës i Prespës strehon një varietet habitatesh dhe forma jetësore duke krijuar kështu një mozaik natyror: nga liqenet e ligatinat deri tek pyjet e dushkut e të ahut dhe livadhet alpinë. Prespa është shumë e njohur për dëllenjat dhe shumimin e pelikanit dalmat. Janë mbi 1200 çifte të Pelikanit Dalmat që folezojnë në kallamishtet e Prespës së Vogël, duke krijuar jo vetëm një nga zonat e pakëta në Evropë, por dhe koloninë më të madhe në botë. Më shumë se 270 lloje zogjsh janë vendosur në zonë, disa prej të cilëve janë të rrallë si Pelikani Rozë, karabullaku i vogël, shtatë lloje çafkash, pata e egër, dhe Kojliku i zi. Pellgu ujëmbledhës i Prespës ka një shumëllojshmëri të pamasë prej më shumë se 1500 lloje bimore, ndër të cilat bima endemike e kokocelit (*Centaurea Prespana*). Liqenet e Prespës sigurojnë ambjent për gjitarët, zvarranikët e amfibët dhe 23 lloje peshqish, tetë prej të cilëve janë endemike të tilla si trofta e Prespës (*Peristericus Salmo*).

shpendëve, liqeni konsiderohet i një rëndësie të lartë ndërkombëtare. Më shumë se 80 lloje bimësh të larta ujore gjenden në zonën e liqenit, disa nga të cilat janë endemike apo të rrezikuara, të tilla si: *Marsilea quadrifolia*, *Nuphar spp*, *Trapa natans*, *Sagittaria sagitifolia*, *Najas marina*, *Schoenoplectus lacustris*, *Potamogeton*, *Leucoium aestivum*. Liqeni njihet për praninë e 49 llojeve të peshqve, midis tyre 6 lloje troftash. Disa lloje peshqish migrojnë në det, ashtu sikurse Blini i Europës (*Acipenser sturio*) i rrezikuar në mbarë botën.



Lycaena dispar © Milan Vogrin ►



Ardea alba at Paratuk Island, Montenegro ►
© Thomais Vlachogianni




▲ *Kalimera fishing nets, Bojana river, Montenegro*
© Milan Vogrin

Lumi Buna: një mozaik habitatesh të pasur biologjikë

44 km² e lumit Buna përshkon Liqenin e Shkodrës dhe derdhet në Detin Adriatik duke formuar një deltë natyrore të rrallë. Lumi i cili ndahet midis Shqipërisë dhe Malit të Zi ka formuar një peizazh të pasur dhe të variueshëm duke i dhënë jetë një diversiteti marramendës bimësh dhe kafshësh. Lumi Buna është një mozaik i natyrës i formuar nga habitate të larmishme, përfshirë ujërat e freskët (liqen dhe lumë) ujërat e njelmët (grykë-derdhje e gjerë dhe lagunë), zonën pyjore, moçale, kullotat enjomë, ranishtet dhe habitatet shkëmbore. Këto habitate strehojnë një larmi të madhe të florës dhe faunës, ku disa prej të cilave janë të kërcënuara globalisht si psh: Saleporja (*Nacampsis laxiflora*) Midhja e zakonshme e lumenjve (*Unio crassus*), Fluturza e bakërt e madhe (*Lycaena dispar*), Blini i Europës Perëndimore (*Acipenser sturio*), Rosa kryebardhë (*Oxyura leucocephala*), Trofta buzëbutë/Trofta Adriatike (*Salmo obtusirostris*), Baldosa (*Lutra lutra*), Bretkoca e pemëve (*Hyla arborea*), etj. Një tipar dallues i lumit Buna është që shërben si një korridor për emigrimin e peshqëve dhe zogjve. Kur është fjala për këtë të fundit, kjo zonë është pjesë e një prej rrugëve migratore veriore – jugore të zogjve Evropiane. Kjo është zonë për folezimin e lloje të shpendëve me rëndësi ruajtjeje Evropiane, të tillë si: Capka sqeplugë (*Platalea leucorodia*), Gjeraqina kembeshkurter (*Accipiter brevipes*), dallëndyshja e natës, lorëza (*Camprimulgus europaeus*), Gjoni (*Otus scops*), etj.

Drini i Zi dhe Drini i Bardhë

Drini dhe zonat malore përreth shfaqin një larmishmëri të madhe të florës dhe faunës. Lumi i Drinit të Zi ndahet midis Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërisë. Ai buron nga liqeni i Ohrit në Strugë dhe pas 50 km arrin Shqipërinë në perëndim të Dibrës. Ai bashkohet me Drinin e Bardhë- një lumë prej 175 km i ndarë midis Shqipërisë dhe Kosovës - në Kukës, për të formuar lumin Drin, i cili derdhet në Detin Adriatik. Drini dhe degët e tij, strehojnë së bashku grupe të shumta të kafshëve, Kavallin e Drinit (*Eudontomyzon Stanko Karaman*), Mrenën e Fanit (*Barbus rebeli*), Gruncin e vogël/Gruncin e Ohrit (*Pelago minutus*), Skortën e Drinit/Skortën e verdhë (*Rutilus Karamani*), sfungjerin e Stankovicit (*Spongilla Stankovici*) etj.



LLOJET

NË QENDËR
TË VËMENDJES

Pelikani Dalmat (*Pelecanus crispus*) Lloji flamur` i rajonit


Në mesin e llojeve të shumta të shpendëve në pellgun e lumit Drin, Pelikani Dalmat (*Pelecanus crispus*) është pa dyshim një nga llojet 'flamur' të rajonit. Rreth një e katërta e popullatës globale rritet në Evropë me koloninë më të madhe të gjetur në Prespën e Vogël me rreth 1200 çifte. Pelikanët rriten midis vegjetacionit ujor në ishuj pluskues apo stacionarë, të izoluar nga zona tokësore për të evituar llojet e gjitarëve. Fole të tyre zakonisht përbëhen nga një grumbull kallamish, bar dhe shkopinj që mund të arrijnë deri në 1m lartësi dhe 1.5m në diametër. Pelikanët ushqehen pothuajse tërësisht me peshk, dhe veçanërisht: krap, Sharmaku i egër, skorta, Lloska pendëkuqe. Rëni në numër, në të kaluarën, janë shkaktuar kryesisht nga: tharjet e ligatinave, gjuetia dhe keqtrajtimi nga ana e peshkatarëve si dhe gjuetia ilegale. Të tjera kërcënime të vazhdueshme përfshijnë: shqetësimet nga turistët, alterimet ligatinore dhe shkatërrimi i tyre, ndotja e ujit, goditje me eksploziv dhe mbi-shfrytëzim i rezervave të peshkut.



▼ *Microcarbo pygmeus* © Milan Vogrin

Anguilla Anguilla © Gregor Šubic ►

Fishing at Lake Shkoder/Skadar
© Thomais Vlachogianni ►



▲ *Ohrid lake* © Thomais Vlachogianni

Ngjala Europiane (*Anguilla Anguilla*) një lloj i rrezikuar në mënyrë kritike

Një shembull karakteristik i një lloji të rrezikuar në rajon është ngjala Evropiane (*Anguilla anguilla*), e cila historikisht përdor lumin Drin për të migruar ndërmjet liqeneve të Ohrit e Shkodrës dhe Detit Adriatik. Ndryshimet në rrjedhën e ujit (kryesisht për shkak të digave) dhe sasia e cilësia e burimeve ujore në të gjithë pellgun ujëmbledhës, kanë shkaktuar dëme të rënda në lëvizjen e peshkut, duke rrezikuar në mënyrë kritike ngjalën Evropiane (lista e kuqe në IUCN) dhe lloje të tjera, të cilat përballen me një rrezik të lartë zhdukje në të ardhmen e afërt.





Pyjet e Dëllinjës në Prespë

Rajoni Liqeneve të Prespës është një nga zonat e pakta në Ballkan ku pyjet e dëllinjës ende mund të gjenden të ruajtura mirë. Kjo zonë pyjore është shumë e rrallë në Evropë dhe ka një sistem të veçantë mbrojtje sipas legjislacionit Evropian. Greqia është në të vërtetë i vetmi vend në Bashkimin Evropian ku ekzistojnë pyjet e dëllinjës. Lloji mbizotëruese është Dëllinja Greke (*Juniperus excels*) dhe Bërsheni (*Juniperus Foetidissima*) gjithashtu është shfaqur në disa zona. Pyjet e dëllinjës së Prespës dhe masivët jetëgjatë të dëllinjave kanë rëndësi të veçantë duke qënë se janë strehues për qindra lloje bimësh dhe kafshësh, shumë prej të cilave janë endemike, ose janë klasifikuar si të rrezikuara, sipas ligjeve ndërkombëtare ose kombëtare.



▲ *Juniper woods, Prespa* © Thomais Vlachogianni





▲ Lesser Prespa © Thomais Vlachogianni



◀ *Salmo letnica* © Thomais Vlachogianni



▲ *Lynx lynx balcanicus* © MES

Trofta e famshme e Ohrit (*Salmo Letnica*) një lloj i lashtë në rrezik

Trofta e famshme e Ohrit (*Salmo letnica*) është një lloj i lashtë dhe endemik që jeton në Liqenin e Ohrit dhe në Drinin e Zi. Një delikatesë lokale që rritet mbi 11 kg, është kthyer në shqetësimin kryesor, sikurse të gjitha të dhënat sugjerojnë se popullatat e koranit janë stresuar ashpër.

Mbipeshkimi duket të jetë shkaku kryesor, së bashku me humbjen e habitatit dhe ndotjen. Një tjetër kërcënim në rritje është futja e llojeve invazive në liqen. Shqetësim të veçantë përbën trofta Ylber jo-native që mund të zhdukë troftën native.

Rrëqebulli i Ballkanit: Një lloj "Flamur" i Ballkanit jug-perëndimor në prag të zhdukjes

Rrëqebulli i Ballkanit (*Lynx lynx balcanicus* / *martinoi*), është një mace e rrallë e egër dhe 'karizmatike' që endet në jug-perëndim të Ballkanit. Ne e gjejmë atë kryesisht në zonat kufitare mes Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërisë, dhe nga atje ai përhapet në veri në Malin e Zi dhe Kosovë. Rrëqebulli Euroaziatik u zhduk në malet Dinarike në fillim të shekullit të 20-të, ndërsa një popullsi e izoluar e rrëqebullit arriti të mbijetojë në jug-perëndim të Ballkanit. Në ditët e sotme, popullsia e tyre vlerësohet të jetë afër dyzet individë, duke reflektuar një situatë shumë më të përkeqësuar se sa vlerësimet e mëparshme të ekspertëve (2004) prej rreth njëqind individë. Kërcënimet kryesore të rrëqebullit të Ballkanit përfshijnë persekutimin e tyre të drejtpërdrejtë në të kaluarën; Rënia e popullatave të gjahut të tyre; fragmentimi, përkeqësimi dhe humbja e habitatit, pjesërisht për shkak të ndërtimit të centraleve hidroelektrike përgjatë lumit Drin.




VEPRIM I KOORDINUAR PËR NJË TË ARDHME TË QËNDRUESHME —TË BASENIT TË LUMIT DRIN—

Memorandumi i Mirëkuptimit Për Drinin

Veprimi i koordinuar në nivel të Basenit të Drinit ka munguar deri në nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit (Tiranë, 25 nëntor 2011) nga Ministri e Ministrive kompetente të pesë vendeve Drinit. Ky ishte rezultat i Dialogut për Drinin (2008-2011) koordinuar nga Global Water Partnership –Mediterranean - Partneriteti Global i Ujit për Mesdheun (GWP-Med) dhe UNECE.

Objekti kryesor i Memorandumit të Mirëkuptimit të Drinit është “Promovimi i veprimeve të përbashkëta për menaxhimin e koordinuar dhe të integruar të burimeve të përbashkëta ujore në Basenin e Drinit, si një mjet për të mbrojtur dhe restauruar, deri në masën e mundshme, ekosistemet dhe shërbimet që ato ofrojnë, dhe për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm në Basenin e Drinit”.

Qëllimi përfundimtar i punës në Basenin e Drinit është arritja e një pike në të ardhmen, ku shkalla e menaxhimit ngrihet nga një trup i vetëm ujortek një sistem i ndërlidhur hidrologjik i Basenit të Drinit, duke drejtuar eventalisht që nga ndarja e ujërave mes të vendeve dhe përdorimeve konfliktuale, tek ndarja e përfitimeve ndërmjet grupeve të interesit.



Veprimi i Koordinuar për Drinin

Procesi i quajtur “Veprimi i Koordinuar për Drinin”, për zbatimin e MoU për Drinin, u vendos pas nënshkrimit të këtij të fundit. Sipas dispozitave të Memorandumit të Mirëkuptimit për Drinin, u krijua një strukturë institucionale përkatëse. Drin Core Group – Grupi qendror i Drinit (DCG) është organi, i cili ka mandatin për të koordinuar veprimet për zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit. Sekretariati i DCG-së ofron mbështetje teknike dhe administrative për DCG; GWP-Med, emëruar nga palët përmes MoU, shërben si sekretariat i DCG. Veprimet për zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për Drinit momentalisht po përkrahen nga Global Environment Facility¹ (GEF), Projekti I GEF për Drinin.


¹ www.thegef.org

Projekti i GEF për Drinin

Projekti i GEF “Mundësimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe menaxhimit të integruar të burimeve ujore në basenin e zgjeruar të lumit Drin” është në përputhje me përmbajtjen, qëllimet dhe objektivat e Memorandumit të Mirëkuptimit për Drinin.

Objekti është të promovohet menaxhimi i përbashkët i burimeve të përbashkëta ujore të basenit ndërkufitar të lumit Drin, duke përfshirë mekanizmat koordinues mes komisioneve dhe komiteteve të përbashkëta të nën-baseneve. Shqipëria, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova dhe Mali i Zi janë përfituesit e projektit. Projekti zbatohet nga UNDP dhe ekzekutohet nga GWP-Mediterranean (GWP-Med). Drin Core Group është Komiteti Drejtues i Projektit.





▼ *Ulcinj Salinas, Montenegro* © Thomais Vlachogianni

ACT 4
DRIN
Living well in harmony
with the Drin



▲ *Calopteryx splendens* © Thomais Vlachogianni



Referencat

- Albrecht C, Trajanovski S, Kuhn K, Streit B, Wilke T. Rapid evolution of an ancient lake species flock: Freshwater limpets (Gastropoda: Ancyliidae) in the Balkan Lake Ohrid. *Organisms Diversity & Evolution*, 6 (4): 294–307, 2006.
- Albrecht C, Wilke T. Ancient Lake Ohrid: biodiversity and evolution. *Hydrobiologia*, 615: 103–140, 2008.
- Amataj S, Anovski T, Benischke R, Eftimi R, Gourcy LL, Kola L, Leontiadis I, Micevski E, Stamos A, Zoto J. Tracer methods used to verify the hypothesis of Cvijic about the underground connection between Prespa and Ohrid Lakes. *Environmental Geology* 51 (5), 749–753, 2007.
- Belmecheri S, Namiotko T, Robert C, Von Grafenstein U, Danielopol DL. Climate controlled ostracod preservation in Lake Ohrid. *Palaeogeography, Palaeoclimatology, Palaeoecology* 277: 236–245, 2009.
- Breitenmoser-Würsten U, Von Arx M, Bego F, Ivanov G, Keçi E, Melovski D, Schwaderer G, Stojanov A, Spangenberg A, Trajçe A, Linnell JDC. Strategic planning for the conservation of the Balkan lynx. *Proceedings of the III Congress of Ecologists*, 2008.
- Cullaj A, Hasko A, Miho A, Schanz F, Brandl H, Bachofen R. The quality of Albanian natural waters and the human impact. *Environment International*, 31: 133–146, 2005.
- Faloutsos D, Constantianos V, Scoullos M. Assessment of the management of Shared Lake Basins in Southeastern Europe. A report within GEF IW:LEARN Activity D2. GWP-Med, Athens, 2006.
- Griffiths HI, Krystufek B, Reed JM (Eds.) *Balkan Biodiversity: Pattern and Process in the European Hotspot*. Kluwer Academic Publishers, Dordrecht, The Netherlands, 2004.
- Kostoski G, Albrecht C, Trajanovski S, Wilke T. A freshwater biodiversity hotspot under pressure – assessing threats and identifying conservation needs for ancient Lake Ohrid. *Biogeosciences Discuss*, 7: 5347–5382, 2010.
- Matzinger A, Jordanoski M, Veljanoska-Sarafiloska E, Sturm M, Müller B, Wüest A. Is Lake Prespa jeopardizing the ecosystem of ancient Lake Ohrid? *Hydrobiologia*, 553 (1), 89–109, 2006.
- Mazzinia I, Gliozzia E, Kocic R, Soulie-Märsched I, Baneschig I, Sadorih L, Giardinih M, Van Welden A, Bushatij S. Historical evolution and Middle to Late Holocene environmental changes in Lake Shkodra (Albania): New evidences from micropaleontological analysis. *Palaeogeography, Palaeoclimatology, Palaeoecology*, 419: Pages 47–59, 2015.
- Melovski D, Ivanov G, Stojanov A, Avukatov V, Trajçe A, Hoxha B, Von Arx M, Breitenmoser-Würsten U, Hristovski S, Shumka S, Breitenmoser U. Distribution and conservation status of the Balkan lynx (*Lynx lynx balcanicus* Bureš, 1941). *Proceedings of the 4th Congress of Ecologists with International Participation, Ohrid*, 12–15 October 2012, MES.
- Ministry of Environment and Physical Planning. Assessment and evaluation of Biodiversity on national level. Report and National Catalogue (Check List) of Species. Skopje, May 2010.
- Panagiotopoulos K, Aufgebauer A, Schäbitz F, Wagner B. Vegetation and climate history of the Lake Prespa region since the Lateglacial. *Quaternary International* 293, 157–169, 2013.
- Petit R, Aguinalalde I, De Beaulieu JL, Bittkau C, Brewer S, Cheddadi R, Ennos R, Fineschi S, Grivet D, Lascoux M, Mohanty A, Müller-Starck G, Demesure-Musch B, Palmé A, Martin JP, Rendell S, Vendramin GG. Glacial refugia: hotspots but not melting pots of genetic diversity. *Science*, 300(5625): 1563–1565, 2003.
- Ramsar Convention Bureau, Information Sheet on Ramsar Wetlands (RIS). Categories approved by Recommendation 4.7, as amended by Resolution VIII.13 of the Conference of the Contracting Parties. (<https://rsis Ramsar.org/RISapp/files/RISrep/AL1598RIS.pdf>)
- Schneider-Jacoby M, Schwarz U, Sackl P, Dhora D, Saveljic D, Stumberger B. Rapid assessment of the Ecological Value of the Bojana-Buna Delta (Albania / Montenegro). Euronatur, Radolfzell, 2006.
- Scoullos M, Faloutsos D, Libert B. The Drin Coordinated Action. Towards an Integrated Transboundary Water Resources Management. Chapter in "Water Scarcity, Security and Democracy: a Mediterranean Mosaic. Global Water Partnership Mediterranean, Cornell University and the Atkinson Center for a Sustainable Future, 2014.
- Scoullos M, Hatzianestis J. Dissolved and particulate trace metals in a wetland of international importance: Lake Mikri Prespa, Greece. *Water, Air, and Soil Pollution*, 3-4: 307–320, 1989.
- Scoullos M, Hatzianestis J. Trace metals in the sediments of a remote mountain lake: Mikri Prespa, Greece Air Pollution Research Report, 20: 129–146, 1990.
- Scoullos M. Prespa National Park. Management and Protection Importance. Hellenic Society, Athens, 1987.
- Scoullos M. Transboundary IWRM Attempts in the Mediterranean. Emphasis on the Drin River Case and the Involvement of Stakeholders. In "Integrated Water Resources Management in the Mediterranean Region: Dialogue Towards New Strategy". Redouane CA, Rodriguez-Clemente R. (eds.), Dordrecht, Springer, 2012.
- Skoulikidis N, Economou A, Gritsalis K, Zogaris S. Rivers of the Balkans. Chapter in "Tockner K, Uehlinger U, Robinson C. Rivers of Europe.
- Skoulikidis N. The environmental state of rivers in the Balkans—A review within the DPSIR framework. *Science of The Total Environment*, 407 (8), 2501–2516, 2009.
- Society for the Protection of Prespa, SPP, 2011. Number of Species. Retrieved 27.11.2011, from: http://www.spp.gr/spp/species%20chart_en.pdf
- Stankovic S, The Balkan Lake Ohrid and its living world. Monogr Biol 9. Uitgeverij, Dr. W. Junk, Den Haag, Netherlands, 1960.
- Tziritis E. Environmental monitoring of Micro Prespa Lake basin (Western Macedonia, Greece): hydrogeochemical characteristics of water resources and quality trends. *Environmental Monitoring and Assessment*, 186(7):4553–4568, 2014.
- Vemic M, Rousseau D, Du Laing G, Lens P. Distribution and fate of metals in the Montenegrin part of Lake Skadar. *International Journal of Sediment Research*, 29 (3): 357–367, 2014.
- Wagner B, Wilke T. Evolutionary history of the Balkan lakes Ohrid and Prespa, *Biogeo-sciences*, 8: 995–998, 2011.



▲ *Melitaea Phoebe* © Thomais Vlachogianni







Act4Drin partners

ISBN: 978-960-6793-19-6



Act4Drin promoters



Ky publikim është zhvilluar në kuadër të projektit "Vepra për Drinin (Act4Drin)" të financuar nga Fondi i Partneritetit të Ekosistemeve Kritike, një iniciativë e përbashkët e Agjencisë Franceze të Zhvillimit, Ruajtjes Ndërkombëtare, Bashkimit Evropian, Facilitetit Global të Mjedisit (GEF), Qeverisë Japoneze, Fondacionit MacArthur dhe Bankës Botërore. Qëllimi themelor i CEPF është të sigurojë që shoqëria civile është e angazhuar në ruajtjen e biodiversitetit.



Ky botim i dytë është prodhuar në bashkëpunim me Partneritetin Global të Ujit për Mesdheun (GWP-Med), nën Drin CORDA me mbështetjen e projektit të GEF për Drinin.

